



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



04/ *7/14* /2026

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

RAPORTI I PUNËS DHE AKTIVITETEVE PËR MUAJIN DHJETOR 2025

Hani i Elezit, 2026

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa për muajin Dhjetor 2025, funksionin e vet e ka ushtruar në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore mbi qeverisjen e Komunave të Republikës së Kosovës, Statutin e komunës së Hanit të Elezit, Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin mbi financat e pushtetit lokal, Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Ligjin mbi tatimin në pronën e paluajtshme, Rregulloret dhe udhëzimet administrative nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Drejtoria për Buxhet dhe Financa me qëllim të realizimit sa më efikas të të gjitha kompetencave dhe përgjegjësi, ka funksionuar kryesisht në katër (4) sektorë:

1. Sektori për buxhet
2. Sektori për financa,
3. Sektori për të hyra dhe
4. Sektori i tatimit në pronë.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa e menaxhuar nga drejtoresha e drejtorisë dhe me një staf prej (6) zyrtarëve, gjatë muajit Dhjetor 2025 kishte një angazhim permanent, me një përkushtim të madh në drejtim të realizimit sa më të suksesshëm të të gjitha objektivave dhe detyrave të parashikuara në planin e punës së drejtorisë. Aktiviteti i drejtorisë ka qenë i përqëndruar në realizimin e buxhetit sipas dinamikës së planifikuar dhe menaxhimin sa më efikas të buxhetit.

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me **NR. 08/L-332 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2025** është në lartësi prej **3,615,457.00 Euro**.

Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim:

- Paga dhe shtesa..... 2,188,542.00 €,
- Mallra dhe shërbime..... 584,500.00 €,
- Shpenzimet komunale94,000.00 €,
- Subvencione dhe transfere ...143,000.00 €,
- Shpenzime kapitale 605,415.00 €,
- Totali i buxhetit..... 3,615,457.00 €.

Punët dhe aktivitetet të cilat janë zhvilluar gjatë këtij muaji, mund t'i veçojmë këto:

SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

- Deklarimi në Thesar obligimet e pa paguara dhe ato kontraktuale për muajin Nëntor 2025,
- Barazimi me Thesar periudha Janar-Nëntor 2025,
- Është dërguar për publikim borxhi publik i muajit Nëntor 2025 në ueb faqen komunale,
- Përgatitja dhe publikimi i raportit të punëve dhe aktiviteteve të muajit Nëntor 2025, në dy formate: Word dhe PDF,
- Hartimi i raportit mujor të të hyrave dhe shpenzimeve të muajit Nëntor 2025,
- Publikimi i Raportit Financiar për periudhën Janar-Shtator 2025, në ueb faqen komunale në tri formate: Word, PDF dhe Excel,
- Përgatitja e Planit të punës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për vitin 2026,
- Publikimi i Buxhetit të vitit 2026 dhe parashikimet buxhetore 2027-2028 në ueb faqen komunale, me të gjitha tabelat e caktuara, përfshirë:

1. Tabela 4.1 Plani i ndarjeve buxhetore për vitin 2026,
2. Tabela 4.2 Financimi i investimeve kapitale 2026-2028,
3. Tabela 4.3 Plani Afatmesëm i Të hyrave Vetanake 2026-2028.

Përveç tabelave të gjeneruara nga Sistemet PIP dhe BDMS, është bërë publikimi i buxhetit edhe në formatin e Excel, Word dhe PDF.

- Hartimi i planit të prokurimit të DBF për vitin 2026,
- Llogaritja dhe realizimi i të gjitha pagesave të destinuar për pagesën e pagave dhe shtesave të Administratës Komunale, të këshilltarëve Komunal, komiteteve të ndryshme të Kuvendit, të Sektorit të Arsimit dhe Sektorit të Kujdesit Primar Shëndetësor.

RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT PËR MUAJIN DHJETOR 2025

Kategoritë ekonomike të shpenzimeve	Buxheti 2025	Realizimi Dhjetor 2025	% Realizim
Paga dhe shtesa	2,333,505.44	201,021.65	8.6 %
Mallra dhe shërbime	1,048,306.44	194,080.79	18.5 %
Shpenzime komunale	114,000.00	11,544.85	10.1 %
Subvencione dhe trans.	193,520.00	41,194.80	21.2 %
Shpenzime kapitale	1,295,254.03	387,754.30	29.9 %
TOTAL	4,984,585.91	835,596.39	16.7 %

SEKTORI PËR TË HYRAT

Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2025 është në shumë prej 339,719.00 €. Inkasimi i të hyrave për muajin Dhjetor është në shumë prej 191,377.29 €. Ndërsa nga muaji Janar deri në muajin Dhjetor nga të hyrat direkte dhe indirekte kemi inkasuar 1,417,269.16 € ose 1,077,550.16 € tejkalim në vlerë tejkalim prej projeksionit vjetor.

- Regjistrimi, harmonizimi i të hyrave ditore në SIMFK,
- Pranimi i një donacioni nga Bashkimi Evropian në shumë prej 168,802.34 €,

SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

Gjatë këtij muaji, ky sektor ka kryer shërbime të rregullta ndaj qytetarëve, siç janë:

- Lëshimin e faturave të tatimit në pronë,
- Lëshimin e vërtetimeve për qëllime të ndryshme.

Drejtores për Buxhet dhe Financa

Lindita Ballazhi

